

1) Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim Menaxhimit kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë Asistent Lektor në grupin mësimor shkencor të Teknologjisë Mekanike për lëndët:

- Teknologji Mekanike
- Teknologji Mekanike 2

Kriteret e propozuara për kandidatët janë si më poshtë:

1. Të ketë diplomë të ciklit të dytë në Inxhinieri Mekanike.
2. Kandidati të ketë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta të të dy cikleve apo të ciklit të integruar jo më pak se 80/100.
3. Preferohet me të paktën një vit eksperiencë profesionale dhe/ose akademike.
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një nga gjuhët: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.

2) Fakulteti i Gjeologjisë dhe të Minierave, Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare, kërkon të punësojë personel akademik me kohë të plotë si më poshtë;

I. GRUPI MËSIMOR KËRKIMOR I GJEOINXHINIERISË:

1 (një) Asistent Lektor

Kandidati duhet të plotësoj këto kriteret:

1. Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në sistemin 5 (pesë) vjeçar në degën Inxhinier Miniere, Master Shkencor në Gjeoinxhinieri, Master Shkencor në Markshajderi (Gjeomatikë), ose në fushën e inxhinierisë së minierave në universitete jashtë vendit;
2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), të studimeve (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (e barabartë ose më e lartë se 8);
3. Preferohet të ketë përvojë pune në fushën e nxjerrjes së mineraleve, projektimit në miniera si dhe në fushën e gjeomatjeve;
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi.

II. GRUPI MËSIMOR KËRKIMOR I GJEOMATIKËS:

1 (një) Lektor

Kandidati duhet të plotësoj këto kritere:

1. Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në Fakultetin e Histori-Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ose në Universitete të huaja analoge, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor + Master Shkencor);
2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), të studimeve (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (e barabartë ose më e lartë se 8);
3. Të ketë, së paku, Gradën shkencore "Doktor". Titulli akademik përbën përparësi;
4. Preferohet të ketë përvojë pune në fushën e modelimeve hartografike, hartografinë numerike dhe GIS;
5. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi;
6. Përvoja në mësimdhënie përbën përparësi.

III. GRUPI MËSIMOR KËRKIMOR I PËRPUNIMIT TË MINERALEVE DHE MBETJEVE:

1 (një) Lektor

Kandidati duhet të plotësoj këto kritere:

1. Të ketë mbaruar studimet në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, ose Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor+Master Shkencor) në fushën e Përpunimit të Mineraleve e Mbetjeve ose Inxhinierisë së Gjeomjedisit;
2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), të studimeve (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë ≥ 8 (e barabartë ose më e lartë se 8);
3. Të ketë, së paku, Gradën shkencore "Doktor". Titulli akademik përbën përparësi;
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj perëndimore (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht) të mbrojtur dhe të vërtetuar me dëshmi;
5. Preferohet të ketë përvojë pune në fushën e Përpunimit të Mineraleve dhe Mbetjeve apo në institucionet që lidhen me këtë Industri.
6. Veprimtaria kërkimore dhe botuese në fushën e Pasurimit të Mineraleve dhe të Gjeomjedisit përbëjnë përparësi;
7. Përvoja në mësimdhënie përbën përparësi.

DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë duhet të paraqesin brenda datës **23.10.2020** pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.